



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Assambly
JUNIK

Rregullorja Komunale nr.7/2009

RREGULLORE

**MBI KOMPENSIMET NË PROCEDUREN E KRYERJES SË
MBIKËQYRJES INSPEKTUESE PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE
HIGJENIKE –TEKNIKE**

Junik
Korrik , 2009

Në bazë të nenit 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe të Statutit të Komunës së Junikut, nenit 20 dhe 53. Kuvendi i Komunës Junik, në mbledhjen e mbajtur më datë: 28.07.2009, miratoi këtë :

RREGULLORE
MBI
KOMPENSIMET NË PROCEDURËN E KRYERJËS SË MBIKËQYRJES
INSPEKTUESE PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE HIGJENIKE-TEKNIKE

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e shpenzimeve të bëra në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese (Komisioni Komunal), sipas kërkesës së palës me qëllim të përcaktimit të plotësimit të kushteve minimale, në shqyrtimin e hapësirave punuese, pajisjeve dhe stabilimenteve, kushteve higjienike-sanitare dhe kushteve të mbrojtjes në punë, për fillimin e punës dhe kryerjes së veprimtarisë.

Neni 2

Parashtruesi i kërkesës është i obliguar që para parashtrimin të kërkesës në emër të kompensimeve të procedurës së mbikëqyrjes inspektuese të paguaj shumën e caktuar në të holla sipas objektit dhe atë:

Nr. r.	E m ë r t i m i	Vlera në €uro
1	Objektet industriale – prodhuese	200
2	Shitoret me shumicë – depot	100
3	Shitja e derivateve të naftës	80
4	Hotelet dhe motelet me restorante	150
5	Restorantet	80
6	Klinikat dhe ordinancat mjekësore	80
7	Barnatoret Humane	80
8	Laboratorët Biokimik	50
9	Barnatoret Bujqësore	80
10	Vetëshërbimet	70
11	Gjellëtoret, ëmbëltoret, kafiteritë	50
12	Dyqanet e pavarur tregtare	30
13	Dyqanet e pavarura zejtare	20
14	Serviset e TV, Radio aparateve, pajisjeve të amvisërisë etj.	20
15	Zyrat për përkthim në gjuhët e huaja	30
16	Avukaturat	50
17	Kioskat	10
18	Agjensit turistike dhe të sigurimit	50
19	Zyrat administrative – selia e biznesit	30
20	Auto parkingjet	20
21	Pishinat	20
22	Hekurishtat	30
23	Auto larje	20
24	Vullkanizer (Gomister)	30

25	Bankat	150
26	PTK	200
27	Këmbimoret	50
28	Fushat sportive	30
29	Objektet për përpunimin e qumështit	30
30	Fermat	30
31	Prodhuesit individual të pijeve	80
32	Qendrat Tregtare	200
33	Supermarketet, Hipermarketat	100
34	Automekanikët	30
35	Auto elektrikistit	30
36	Seperacionet	100
37	Prodhimi i gypave, kubëzave etj. prej betoni	100
38	Prodhimi i gypave, dyerve, dritareve etj. prej plastike	100
39	Depot e materialit ndertimor	100
40	Zdrukëthtarët – Marangozët	50
41	Të tjera	50

Neni 3

3.1 Për vlerësimin mbi plotësimin e kushteve minimale teknike-sanitare, për ushtrimin e veprimtarisë së hapësirave dhe lokaleve, stabilimenteve dhe pajisjeve duhet të formohet komisioni përkatës i përbërë nga këta inspektor: Inspektori i Punës, tregut, sanitar ndërsa inspektorët tjerë sipas nevojës.

3.2 Ky komision mbikëqyrjen e kryen në orar të punës respektivisht ditëve të punës.

Neni 4

4.1 Shumën në të holla të përcaktuar në emër të kompensimit të shpenzimeve të parapara sipas neni 2 të kësaj Rregulloreje, parashtruesi i kërkesës duhet të kryej pagesën në bankat, në llogarinë e Kuvendit Komunal të Junikut – “Kontrolli sipas kërkesës së palës”.

4.2 Parashtruesi me rastin e parashtrimit të kërkesës së tij për dhënien e pëlqimit paraprakisht duhet të kryej pagesën sipas alinesë paraprake të këtij neni.

Neni 5

5.1 Me Hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje pushon se aplikuari neni 9, 9.1 dhe 9.2 i rregullores për taksa , ngarkesa dhe gjoba komunale nr. 001/109 të datës 27.03.2009.

5.2 Kjo rregullore hyn në fuqi me datën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS JUNIK

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Zelfishaha Shala

Data: 28.07.2009

Nr. _____